



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



## DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

### ZYRA E TATIMIT NË PRONË

#### Njoftim

Komuna e Fushë Kosovës njofton të gjithë tatimpaguesit se ka lëshuar faturat e Tatimit në Pronë për vitin tatimor 2026.

Tatimpaguesit që janë të regjistruar në sistemin e Tatimit në Pronë me numra personal të Republikës së Kosovës mund të nxjerrin faturën e Tatimit në Pronë drejtpërdrejtë në e-Kosova në linkun <https://ekosova.rks-gov.net/> ose duke u paraqitur personalisht në komunën ku edhe janë pronarë/e ose posedues/e të pronës së paluajtshme.

Afati për pagesën e Tatimit në Pronë për personat fizik rezidentë mund të bëhet në dy këste të barabarta dhe atë:

**Kësti i parë deri më 30 Qershor 2026, dhe**

**Kësti i dytë deri më 30 Shtator 2026.**

Për personat fizik jo-rezident (pa numër personal të Republikës së Kosovës, ose me numër personal të një shteti tjetër të huaj) Tatimi në Pronë mund të paguhet në një këst të vetëm, më së largu në datën 30 Shtator 2026.

**Nëse pagesa nuk paguhet sipas afateve si më lartë pason llogaritja e gjobës dhe interesit si në vijim:**

- Në shumën e tatimit të secilit këst të pa paguar llogaritet një gjobë prej 10%.
- Në shumën e tatimit të secilit këst të pa paguar llogaritet interesi në baza mujore prej 0.65%.

**Ftojmë të gjithë qytetarët që të përmbushin obligimet e tyre tatimore me kohë.**

**Drejtoresha për Zhvillim Ekonomik dhe Tatim në Pronë  
Pranvera Merovci**

